

VENDIM
Nr.637, datë 20.9.2006

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRJETIT TË RI TË
UJËSJELLËS-KANALIZIMEVE, NË FUSHË-KRUJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr.9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave
V E N D O S I:

1.Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i rrjetit të ri të ujësjellës-kanalizimeve, në Fushë-Krujë.

2.Shpronësimi të bëhet në favor të bashkisë së Fushë-Krujës.

3.Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 1353 m² tokë arë, me vlerë të përgjithshme prej 1 983 903 (një milion e nëntëqind e tetëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e tre) lekësh.

4.Shpenzimet procedurale, në shumën 112 500 (njëqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë, të përballohen nga bashkia e Fushë-Krujës.

5.Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 1 983 903 (një milion e nëntëqind e tetëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e tre) lekësh, të përballohet nga buxheti i vitit 2006, zëri “Shpronësime”, miratuar për Ministrinë e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.

6.Shpronësimi të përfundojë brenda datës 20.10.2006.

7.Ngarkohen Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe bashkia e Fushë-Krujës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

**LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN NGA NDËRTIMI I PROJEKTIT
UJËSJELLËSKANALIZIME FUSHË-KRUJË**

Nr	Emri	Pasuria	Zona kadastrale	Sipërfaqja	Çmimi lekë për m²	Vlera në lekë
1	Bashkëpronarët Pashk Steli Filke Steli Petrir Steli Marjana Steli Gjok Steli	45/9	1934	450 m ²	1466.3	659.835
2	Bib Musteqja	53/5	1934	452 m ²	1466.3	662.767
3	Lek Musteqja	52/19	1934	451	1466.3	661.301

Vlera totale e këtij shpronësimi është 1 983 903 (një milion e nëntëqind e tetëdhjetë e tre mijë e nëntëqind e tre) lekë.